

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.J. nga fshati ... për shkak të veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për krime të rënda, PKR.nr.184/15 datë 20.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 02.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.184/15 datë 20.02.2018, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.184/15 datë 20.02.2018, të akuzuarin F.J. në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 dhe 454 paragrafi 1 të KPPRK është liruar nga akuza për veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK. Shpenzimet e procedurës penale bijën barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore – Departamenti për krime të rënda në Gjilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar 1.12 të KPP, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike të paraparë me nenin 386 par.1 të KPP, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta anuloj në tersi dhe ta kthej në rigjykim dhe vendosje.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.J. av. M.S, ka ushtruar përgjigje në ankesën e Prokurorisë duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.134/18 të dt.30.03.2018, ka propozuar që ankesa e prokurorisë të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet, nga ana e prokurorisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPP-së, pasi që aktgjykimi nuk është përpliluar në pajtim me nenin 370 të KPP dhe se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me brendinë e tij, me arsyetimin si dhe faktet vendimtare dhe me përmbajtjen e provave materiale të administruara si në shkresat e lëndës andaj edhe si e tillë është e pa qëndrueshme. Si pasojë e këtyre shkeljeve prokuroria pretendon se ka ardhë edhe deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Nuk qëndron konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se kinse nuk është argumentuar se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar si në aktakuzë. Gjykata është bazuar në deklaratën e të akuzuarit të cilës ia ka falur besimin e plotë e i cili e ka monuar kryerjen e veprës penale me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Kjo deklaratë është dashur të shikohet si tersi apo të krahasohet me provat e tjera të cilat dëshmojnë të kundërtën siç është dëshmia e dëshmitarit B.B., H.Q., ajo e të dëmtuarit K.A. si dhe provave materiale të administruara në shqyrtimin kryesor.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me aktgjykimin lirues për të akuzuarin F.J. e të cilat si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar secilën provë veç e veç, të njëjtat i ka ndërlidhur me njëra tjetrën, ka dhënë arsyet për faktet vendimtare si dhe arsyet e mosmiratimeve të propozimeve konkrete të palëve por edhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykimin lirues. Në tërësi Gjykata e Apelit e Kosovës i mbështetë arsyetimet dhe vlerësimet e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësorë si dhe me vendosjen e kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe atë duke dëgjuar të dëmtuarin K.A. i cili është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, dëshmitarin B.B., H.Q. ndërsa nga provat materiale raportin policor të datës 01.02.2015, vërtetimi mbi konfiskimin e kartëmonedhave, fotodokumentacionin si dhe ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit dhe me të drejtë ka vlerësuar se nuk është kontestuese që të tre të akuzuarit kanë qenë në cilësinë e punëtorëve të KEDS-it, ditën kritike në picerinë e tani të dëmtuarit K.A. i cili kishte një borxh të pa shlyer. Të njëjtit kanë biseduar fillimisht me vllaun e K. e në ndërkohë ka ardhë edhe vetë K.i, i kanë treguar për kabllon të vendosur në mënyrë jo të rregullt për çka edhe i njëjti vetë e ka pranuar edhe i dënuari tani dëshmitari H.Q.. Se rreth orës 15 të së njëjtës ditë H.Q. së bashku me të akuzuarin F.J. kanë shkuar te piceria në fjalë me velurën të cilën e ka vozitur H. duke e parkuar dhe H. ka dalur nga vetura në drejtim të picerisë ndërsa F. ka mbetur në veturën zyrtare. Se H. ka marr nga K. shumën prej 200 eurove për të mos ia çkyqur rrymën, është kthyer në veturë ku ka qenë i akuzuari Fidan, janë nisur nga parkingu dhe pas 30-50 metrave janë ndalur nga policia dhe në xhepat e H. janë gjetur të hollat prej 200 eurove të cilat kanë qenë

të fotokopiuara e që vërtetohet edhe nga vetë H.Q. e që kjo deklaratë përputhet edhe me deklaratën e të dëmtuarit K.A. si dhe ate të akuzuarit F.J., por edhe me prova materiale siç është raporti i policisë, vërtetimi mbi konfiskimin e monedhave dhe fotodokumentacioni i kartëmonedhave 1x100 dhe 2x50 euro. Nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se nuk është provuar se i akuzuari F.J. i ka kërkuar të holla të dëmtuarit K.A. apo që të ketë pasur ndonjë marrëveshje me të akuzuarit e tjerë për të marrë para nga K.i pasi që një gjë të tillë nuk e kanë theksuar asnjëri nga dëshmitarët e as vetë i dëmtuari K.. Ky i dëmtuar ka theksuar se parat ja ka dhënë H.t i cili ia ka kërkuar dhe ja ka marr të njëjtit, F. nuk ka fol asgjë e po ashtu nuk është përmendur se H. duhet me i dhënë F. këto të holla. Po ashtu kjo gjykatë pajtohet me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të dënuarin që tani është dëshmitar H.Q. se deklarata e tij se “të tre përnjëherë në piceri i kanë thënë K.it që për mos ndërprerje të rrymës duhet me i pagua 200 euro” se kjo dëshmi është e pa bazuar me prova por edhe me vetë logjikën e cila thotë se është e pa mundshme që tre persona të njëjtën kohë të kërkojnë shumën e njëjtë kundër një personi e po ashtu edhe fakti se i njëjti nuk ka dhënë shpjegime se si ka mundur një gjë e tillë praktikisht të realizohet. Deklarata e tij nuk është mbështetur dhe në përputhje me provat e tjera e as me dëshmitë e dëshmitarëve K. dhe B.B. të cilët e kanë mohuar një gjë të tillë. Po ashtu ka mbetur i pa vërtetuar pretendimi i të dënuarit tani dëshmitarit H.Q. se edhe i akuzuari Fidan e ka ditur që janë duke shkuar në piceri për ti marrë të hollat por edhe ate se ai nuk e din kur janë marrë vesh me dëshmitarin B.B. dhe të akuzuarin F.J. për të kërkuar para pronarit të picerisë, fakte këto që nuk mundën të provohen as me prova materiale e as ato jo materiale.

Meqë në aktgjykimin e atakuar nuk kemi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të ligjit penal.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.139/2018, më 02.05.2018

Procesmbajtësja,
Eroll Gashi_____

Kryetari i kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala_____